



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**VENDIM**

**NR. 650/1, datë 8.6.2023**

**“Mbi korrigjimin e vendimit nr. 650, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj”**

Sot në datën 8.6.2023, trupi gjykues i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Suela Zhegu</b>	<b>Anëtare</b>

u mbledh për t'u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Firdes Shuli, për korrigjimin e gabimit material/njerëzor në vendimin nr. 650, datë 27.4.2023, të subjektit të rivlerësimit Ylli Pjetërnikaj.

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”:

- “1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij”,*

Në vendimin nr. 650, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është bërë një gabim material/njerëzor në pjesën e dispozitivit pasi nuk është shkruar që vendimi është marë me shumicë votash, sikurse është shpallur në seancën e datës 27.4.2023. Konkretisht, në faqen 73, në fund të paragrafit “për këto arsye” duhet të shtohet togfjalëshi “me shumicë votash”. Në fund të faqes 74, në paragrafin “anëtarët e trupit gjykues”, në krah të emrit të kryesueses Etleda Çiftja, duhet të shtohet fjala “(kundër)”.

Trupi gjykues pasi konstatoi se kërkesa e relatorit qëndron sepse pasaktësia është dukshëm si pasojë e një gabimi material/njerëzor,

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative,

## **V E N D O S I:**

1. Ndrejten e gabimit material në vendimin nr. 650, datë 27.4.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në këtë mënyrë: në faqen 73, në fund të paragrafit “*për këto arsye*” të shtohet togfjalëshi “*me shumicë votash*”. Në fund të faqes 74, në paragrafin “*anëtarët e trupit gjykues*”, në krah të emrit të kryesueses Etleda Çiftja të shtohet fjala “*(kundër)*”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.
3. Të kërkohet kthimi i vendimit të dërguar, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar.
4. Vendimi i korigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Tiranë më 8.6.2023

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda Çiftja**  
**KRYESUESE**

**Firdes Shuli**  
**RELATOR**

**Suela Zhegu**  
**ANËTARE**